



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULATOR I ENERGISË
BORDI

VENDIM

Nr.259, Datë 02.12.2024

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “M.C ENERGY GOJAN” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregulator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1845/15prot., datë 27.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “M.C ENERGY GOJAN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1845 prot., datë 30.08.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Gojan, në pellgun ujëmbledhës të lumit “Fani i Madh,” në zonën e Gojan-Gjegjanit, Qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 15 MW.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 202, datë 27.09.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 01.10.2024 dhe 02.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.10.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 2057 prot., datë 08.10.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, kurse me shkresën nr. 1845/7 prot., datë 04.10.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.

- Pas zhvillimit të korrespondencës me shoqërinë në lidhje me sa më sipër dhe pas shqyrtimit të informacionit/dokumentacionit plotësues të depozituar nga shoqëria, rezulton se në këtë aplikim duhet të saktësohet/plotësohet dhe dokumentacioni që lidhet me: vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dokumentacioni në lidhje me mbështetjen financiare për realizimin e investimit, si dhe informacioni/dokumentacioni në lidhje me statusin e marrjes së miratimit përfundimtar nga OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes me sistemin e transmetimit.
- Në nenin 14, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*
- Me qëllim shqyrtimin e dokumentacionit dhe zhvillimin e ndonjë korrespondence të mundshme me shoqërinë për të sqaruar informacionin/dokumentacionin shtesë të depozituar me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1845/16 prot., datë 27.11.2024, vlerësojmë të zgjatet deri në 10 (dhjetë) ditë pune afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 10 (dhjetë) ditë pune, afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “M.C ENERGY GOJAN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria brenda 5 (pesë) ditëve pune, duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “M.C ENERGY GOJAN” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI